REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2024-012

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala G.K., kundër gjyqtares të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, M.K., më datë 28.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e palës G.K., kundër gjyqtares të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, M.K..

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme, përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës. më datë 30 shtator 2024 është pranuar ankesa e palës G.K., e ushtruar ndaj gjyqtares të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, M.K., tek Kryetari i Gjykatës Supreme si Autoritet Kompetent, konform nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Pala ankuese, ndaj gjyqtares të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, M.K., ka paraqitur ankesën e tij me pretendimin se gjyqtarja ndaj të cilës është paraqitur kërkesa, ka zvarritur procesin e trajtimit të lëndës, me vonesë prej 10 vitesh. I njëjti gjithashtu pretendon se për lëndën në fjalë kishte kërkuar ekspertizë të vlerësimin të pronës si dhe caktim të seancës gjyqësore mirëpo nuk kishte marrë ndonjë përgjigje lidhur me këtë. Duke ju referuar zvarritjes së trajtimit të lëndës C-IV-14-1866, pala në ankesën e tij thotë se e njëjta veprimet e saja në raport me lëndën i ka kryer me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.

Lidhur me pretendimet e palës, kryetari i Gjykatës Supreme, si autoriteti kompetent ka kërkuar nga gjyqtarja M.K., të deklarohet lidhur me këtë rast dhe ka pranuar deklaratën e të njëjtit.

Në deklaratën e tij, gjyqtari K., ka deklaruar se në lëndën C-IV-14-1866, procedura për këtë lëndë ka filluar në vitin 2021, kur ka lëshuar një urdhër që ankuesi brenda 15 ditëve të dorëzojë në gjykatë prova shtesë, pas këtij veprimi është pranuar një parashtresë nga ankuesi me datë 20.12.2021. Në vitin 2022, iu është dërguar paditësit mbrojtjen e AKP-së për përgjigje.

Tutje në deklaratën e gjyqtares thuhet se e njëjta është e ngarkuar me rreth njëmijë lëndë, andaj si pasojë e gjithë kësaj ngarkese duke iu dhënë prioritet rasteve me urgjencë siç janë masat e përkohshme, raportet përfundimtare si dhe lëndët më të vjetra të vitit 2012, 2013 dhe 2014, nuk kam mundur t'ia trajtoi me aq prioritet këtë lëndë. Mirëpo, tani pasi kam bërë kërkesë për krijimin e kolegjit, seanca pritet të caktohet deri në fund të vitit 2024.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së gjyqtarit, si dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitë deklaratës, vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave të lëndës, deklaratës së gjyqtares si dhe nga pretendimet e palës ankuese, rezulton se nuk ka bazë ligjore për hapje të procedurës ndaj gjyqtares M.K.. Gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se gjyqtarja K., nuk ka zvarritur me dashje trajtimin e lëndës mirëpo për shkak të ngarkesës së madhe të punës dhe numrit të lëndëve të prapambetura, ka qenë e detyruar të trajtojë fillimisht lëndët më të vjetra dhe të grumbulluara ndër vite. Duke pasur parasysh se e njëjta është e ngarkuar me lëndë më të vjetra dhe atë për vitet 2008 deri në vitin 2013, me rreth 280 lëndë ndërsa vetëm për vitin 2014 me më shume se 400 lëndë. E njëjta prioritet iu ka dhënë rasteve me të vjetra e atyre me urgjencë, siç janë masat e përkohshme.

Gjithashtu, në lëndën gjyqësore C-IV-14-1866, janë marrë veprime procedurale për mbajtjen e seancës gjyqësore në fund të vitit 2024. Pavarësisht sfidat që po përballet Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme në trajtimin e lëndëve gjyqësore në kohë, gjyqtarët janë duke bërë përpjekje që të trajtojë të gjitha lëndët sipas radhës së pranimit dhe urgjencës së tyre në këtë gjykatë.

Në nenin 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, potencohet se në cilat raste kemi të bëjmë me shkelje disiplinore Në rastin konkret, nëse marrim parasysh të gjitha shkresat e lëndës, veprimet të cilat janë ndërmarrë nga gjyqtarja, nuk mund të arrijmë në përfundim se në këtë rast gjyqtarja ka pasur dashje apo pakujdesi të rëndë gjatë punës së saj lidhur me trajtimin e kësaj çështje.

Andaj, për shkak se nga pretendimet e ngritura në parashtresën e palës, nuk vërtetohet kryerja e ndonjërës shkelje të supozuar disiplinore, e paraparë në nenin 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për

Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Gjyqtares M.K.,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.